

“Në shtëpinë studio të Kadaresë”

Roli kryesor i muzeut kushtuar Kadaresë është të pasqyrojë kohën. Ai ka si qëllim të tërheqë vizitorë vendas dhe të huaj dhe t'u paraqesë vlerat e veprave të Kadaresë dhe punën e jashtëzakonshme që ai ka arritur gjatë jetës së tij.



Faqja 3

“LUFTO PËR JETËN”

Për vite me radhë muaji tetor është konsideruar si periudha kur të tërë duhet të ndërjegjësohemi për sëmundje e kancerit të gjirit. Kjo sëmundje, e cila prek me qindra gra, duhet të jetë gjithmonë në një kontroll të vazhdueshëm.



Faqja 3



Shkolla filloi

Dita e parë e shkollës është një shans për të ndihmuar të rinjtë të ndjehen të mbështetur dhe të inkurajuar. Është një kohë për të krijuar lidhje dhe miqësi të reja, për të gjetur burime të reja të frymëzimit dhe për të ndjekur ëndrrat dhe synimet e tyre me energji dhe vendosmëri.

Faqja 2

Zgjedhjet presidenciale në “HARRY FULTZ”



Zgjedhjet presidenciale në shkollën “Harry Fultz” u zhvilluan me 13 tetor. Nxënësit votuan midis dy kandidateve, Megi Meskuti nga dega e biznesit dhe Brixhet Bali nga dega e elektronikës.

Faqja 2



“Duart që ndihmojnë, janë më të mira se gojët që luten!”

Faqja 4

Klubet në “Harry Fultz”

Klubet janë jo vetëm vendet ku zhvillohen aftësi dhe talente, por edhe hapësira ku krijohen miqësi të forta dhe bashkëpunim midis nxënësve, si një tipar shumë i vlefshëm i gjeneratës së të ardhmes, një gjeneratë e predispozuar ndaj globalizimit.

Faqja 3

Vizitë në kompaninë Coca-Cola - Faqja 5

“Nxënësit e ‘Harry Fultz’-it eksplorojnë botën e auditimit dhe konsulencës financiare në ‘Kreston Albania’! - Faqja 5

MËSIMI DHE SPORTI - Faqja 6

DITA EUROPIANE E GJUHËVE TË HUAJA - Faqja 6

TAPAT PLASTIKE - Faqja 6

Shkolla filloi!

Shkolla e njohur “Harry Fultz” është një institucion arsimor që ka bërë histori në fushën e arsimit në Shqipëri dhe po vazhdon të ofrojë një edukim cilësor të shkëlqyer për të rinjtë e vendit. Në datën 11 Shtator 2023, shkolla filloi një vit të ri të suksesshëm, duke ngjallur entuziazmin dhe vizionin e arsimtarëve dhe studentëve të saj.

Me një histori të pasur mbi 100 vjet në fushën e arsimit, Shkolla “Harry Fultz” është një pionier në përgatitjen e të rinjve për të bërë një ndryshim pozitiv në shoqëri. Me një fokus të qartë në cilësinë e mësimdhënies dhe ndikimin pozitiv në zhvillimin e studentëve, shkolla është një model i arsimit të lartë në vend.

Dita e parë e shkollës, si atëherë fëmijë... gjithmonë përjetohet me emocion, pasion dhe shpresë për të gjithë nxënësit, veçanërisht për nxënësit e viteve të para. Ata dallohen nga sytë kureshtarë. Është një dritare e hapur për një vit të ri të mundësive, zhvillimit personal dhe suksesit të arsimit.

Me zemrat që u rrahin me ritmin e një aventure të re, kalojnë pragun e shkollës me emocion. Ata janë të nxitur dhe tërhiqen nga çdo mundësi që do të prezantojë ky vit shkollor i ri.



Duken të paduruar për të mësuar, eksploruar dhe zhvilluar aftësitë e tyre. Të gjithë janë të pasionuar për të filluar një rrugëtim të ri të dijes dhe kërkimit të njohurive.

Arsimtarët dhe stafi i shkollës, krijojnë një klimë ndjenjash të ngrohta dhe përkushtuese ndaj të rinjve që ata do të udhëheqin gjatë vitit të ardhshëm. Shumë të përgatitur të ndajnë dijet dhe përvojën e tyre me nxënësit dhe të ndihmojnë në zhvillimin e tyre të formimit dhe arsimimit.

Dita e parë e shkollës është një shans për të ndihmuar të rinjtë të ndjehen të mbështetur dhe të inkurajuar. Është një kohë për të krijuar lidhje dhe miqësi të reja, për të gjetur burime të reja të frymëzimit dhe për të ndjekur ëndrrat dhe synimet e tyre me energji dhe vendosmëri.

Një ekip i kualifikuar janë angazhuar për të krijuar një mjedis më tërheqës dhe mbështetës në kabinete për të gjithë nxënësit. Ky staf ka ndërmarrë përpjekje të mëdha për të siguruar infrastrukturën më të mirë për mësimdhënie, duke investuar në teknologjinë e fundit dhe burime të reja të librave.

Një faktor i rëndësishëm që dallon shkollën “Harry Fultz” është përgatitja e studentëve për të bërë ndryshimin në shoqërinë e tyre dhe për të kontribuar në zgjidhjen e sfidave të sotme dhe të ardhshme. Shkolla inkurajon zhvillimin e aftësive të liderëve dhe të ndjeshëm ndaj çështjeve shoqërore shkencën, teknologjinë, gjuhët, dhe shumë fusha të tjera. Kjo e bën shkollën të ofrojë një gamë të gjerë mundësish për studentët e saj për të zhvilluar pasionet dhe interesat e tyre në mësim. Suksese në këtë vit akademik!

Arba Gjyriqi



Zgjedhjet Presidenciale në “Harry Fultz”

Zgjedhjet presidenciale në shkollën “Harry Fultz” u zhvilluan me 13 tetor. Nxënësit votuan midis dy kandidateve, Megi Meskutaj nga dega e biznesit dhe Brixhet Bali nga dega e elektronikës. Procesi i votimit u bë online.

Tanimë prej disa vitesh ky sistem votimi me masat e veta të sigurisë ofron mundësinë që një nxënës të ketë një votë, kohëzgjatjen e votimit etj.” Nga rezultatet e votimit, presidentja e senatit të shkollës “Harry Fultz” për vitin akademik 2023-2024 do të jetë Megi Meskuti.

Një nga mësueset që drejtojnë senatin, mësuese Lefteria, vlerësoi prezantimin dhe fushatën qytetare të vajzave në përballje.

Mësuese Dhurata, gjithashtu drejtuese në senat, thekson bashkëpunimin që treguan të dyja kandidatet bashkë, pavaresisht rivalitetit të tyre. Gjithashtu, në fushatën e tyre, vjzat specifikuan qëllimet dhe sesi ato do të mundoheshin të përfshinin të gjithë nxënësit në veprimtari të ndryshme të shkollës, për të zhvilluar më tej aftësitë e tyre.

Ne bashkebiseduam me presidenten e shpallur të shkollës sonë. Nga Megi morëm disa përgjigje të vlefshme nga përvoja e saj në këtë proces votimi:

“Zgjedhjet presidenciale, edhe pse ishte një proces mjaft intesiv, mund të them se do të mbetet përvojë e bukur prej “Fultz”-it.

Nuk patëm shumë kohë, por mjaftueshëm për të punuar fort dhe për të arritur fitore. Një nga presidentët më të shquar të SHBA, Roosvelt ka thënë: “Për të qenë i suksesshëm në të folurin në publik duhet të kesh parasysh keto rregulla: Të jesh i sqartë, konciz dhe të jesh i përlurur. Konkretisht rrënjët e mia u ujitën me këto parime kyçe, të cilat sollën frytin e suksesit, fitorja”.



Të dyja kandidatet punuan fort për të fituar. Të qenit pjesë e senatit, qeverisë së një shkolle, apo lider i saj, nuk është thjesht një emërim për meritë. Kjo është një detyrë që ngarkon me përgjegjësi dhe që duhet mbajtur me shumë përkushtim. Duke u uruar senatit të ri suksese në punën e tyre, premtojmë t'i mbështesim në veprimtari të që na presin!

Markus Mara



Klubet në “Harry Fultz”

Në shkollën tonë, klubet e ndryshme që kanë për qëllim zhvillimin e aftësive dhe argëtimin e nxënësve janë kthyer në një traditë të përvitshme. Klubet sjellin një atmosferë mbresëlënëse dhe kontribuojnë në pasurimin e përvojës për të gjithë ne. Klubet nuk janë vetëm një vend ku nxënësit marrin pjesë në veprimtari. Është një familje e vogël, ku pasioni dhe angazhimi bëjnë bashkë nxënësit me interesa të ngjashme. Nëpërmjet projekteve që klubet realizojnë, çdokush krijon njohuri të reja dhe përvojë.

Klubet janë të shumta, duke filluar nga klubet sportive, për të gjithë ata që janë të talentar në sporte dhe marrin pjesë në lojëra apo kampionate të ndryshme; te klubet e muzikës të cilët punojnë për t'i shtuar ngjyra dhe jetë çdo veprimtarie të organizuar brenda apo jashtë shkolle e deri te klubi i debatit, mbrojtësit e zjarrtë të mendimit kritik, që tashmë janë kthyer dhe në traditë të “Harry Fultz”-it. Pjesëmarrja vjetore në organizimet e ndryshme të klubit, vlerësohen me një certifikatë në fund të vitit nga Drejtoria e Shkollës.

Klubet janë jo vetëm vendet ku zhvillohen aftësi dhe talente, por edhe hpesira ku krijohen miqësi të forta dhe bashkëpunim midis nxënësve, si një tipar shumë i vlefshëm i gjeneratës së të ardhmes, një gjeneratë e predispozuar ndaj globalizimit.



Kushdo që ka interes dhe dëshirë për të bërë pjesë në çdo klub është i mirëpritur! Në shkollën tonë, çdo nxënës ka mundësinë të gjejë një klub që i përshkruan interesave dhe pasioneve të tyre.

Anduela Alla , Emi Gjokutaj



“Në shtëpinë studio të Kadaresë”

Veprimtaria u zhvillua në 24-31 tetor 2023 me nxënësit e klasave 10-3 dhe 11-7.

Muzeu Shtëpia Studio Kadare, në kuadër të muajit të letërsisë, mirëpriti nxënësit tanë dhe i befasoi ata me dokumente origjinale, objekte personale, historinë, kulturën, kujtime të kohës në të cilën jetoi shkrimtari i madh, Ismail Kadare.

Muzeu u hap me 25 maj 2019, ndodhet në Tiranë dhe është apartamenti ku ka banuar Kadare në vitet 1974 - 1989.

Roli kryesor i muzeut kushtuar Kadaresë është të pasqyrojë kohën. Ai ka si qëllim të tërheqë vizitorë vendas dhe të huaj dhe t'u paraqesë vlerat e veprave të Kadaresë dhe punën e jashtëzakonshme që ai ka arritur gjatë jetës së tij.

Fale mobiljeve autentike të mbetura po ato, librave të koleksionit të Kadaresë e plot objekteve apo detajeve që të çojnë në jetën personale të shkrimtarit, një vizitë këtu i ngjan një takimi fizik me gjenin e letrave shqipe, edhe pse në mungesë të tij.



Studioja private

Ndajesa më e interesante ishte te studija private e shkrimtarit, aty ku spikasnin titujt e librave që kanë ndikuar Kadarenë, disa prej tyre “të ndaluar” për kohën, të vendosur në një raft të bardhë të montuar nga vetë shkrimtari. Përbri librave ndodhej oxhaku. Në krah, ideuar e montuar fshehtas nga arkitekti Maks Velo, ishte frëngjia që i kujtonte shtëpinë e fëmijërisë në Gjirokastrë. Kjo “dritare” e fshehtë shërbente për të parë kush i afrohej studios në të cilën hynin vetëm njerëzit e besuar të shkrimtarit. Tryeza e punës së tij, me makinën emblematike të shkrimit “Hermes Baby”, ishte vendosur përballë tyre.

Salloni qëndror

Një tjetër dhomë interesante është salloni qëndror, ku gjendet githashtu një bufë autentike e kohës kur banoi Kadare në këtë shtëpi, me plot surpriza që fshihen brenda rafteve të saj. Duke hapur kanatet, shohim shkrime origjinale, fotografi familjare të Ismailit, letërkëmbime të tij me personazhe të njohur të botës letrare, madje edhe bllokun e kujtimeve.

Dhoma e ekspozimit

Dhoma e dy vajzave të tij, ka tanimë rolin e dhomës së ekspozimeve të ndryshme, që i dedikohet suksesëve ndërkombëtare të Kadaresë. Ekspozita e parë i kushtohet romanit “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, ku jepet të dhëna shteruese mbi botimin dhe përkthimin në shumë gjuhë të huaja.



Dhoma e filmit

Dhoma e errët, ku ishte improvizuar ekrani i kinemasë në çdo foto bardhë e zi, që paraqiste imazhe nga realizimet kinematografike të veprave të autorit si “Nusja dhe shtetrrëthimi”, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Ballë për ballë” etj. Fjalët

Muzeu ofron dhe një surprizë të fundit. Muret e shtëpisë janë të shkruara me disa nga citimet më të njohura të librave të Kadaresë. Vizitorët kështu bëhen pjesë e një loje të pëlqyeshme, ku humbasin në vargjet e shkrimtarit. Kjo vizitë u mbyll me mbresa nga një kohë që te ne vjen nga historitë e prindërve dhe gjyshërve. Mësuese Alma dhe mësuese Suela që na shoqëruan, na shpjeguan se shpejt do studiojmë Letërsinë e shek. XX. Këto informacione do të na ndihmjnë. Mesazhi që morëm mbi rëndësinë e dokumentimit të ngjarjeve përcjell një britmë mbijetese mbi çdo pengesë që jeta sjell!

Ami Qana

“Duart që ndihmojnë, janë më të mira se gojët që luten!”

Kryqi i Kuq Shqiptar është një orniztë humanitare dhe pjesë e Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe. Ky organizatë u themelua më 27 qershor 1936, dhe është një prej organizatave më të rëndësishme të ndihmës humanitare në Shqipëri dhe në mbarë botën. Kryqi i Kuq Shqiptar ka për qëllim shpëtimin e jetëve, lehtësimin e vuajtjeve, dhe respektimin e dinjitetit të njeriut, duke vepruar në përputhje me parimet dhe vlerat humanitare.

Organizata është e pavarur dhe e neutralitetit, e cila do të thotë se ajo ofron ndihmë humanitare pa dallim të racës, besimit, origjinës, ose orientimit politik. Kryqi i Kuq Shqiptar është i përkushtuar ndaj ndihmës së nevojshme në momente të katastrofave natyrore, emergjencave, dhe konflikteve të ndryshme.

Shkolla jonë brenda kurikulës, ka një lëndë që quhet “Ndihmë komunitare”. Në këtë veprimtari ishin prezent dy klasa të gjimnazit të viteve të dyta. Iu bashkan kësaj nisme dhe nxënës të tjerë të Fultzit të cilët u vetëofruan për vullnetarizëm.

“Duart që ndihmojnë, janë më të mira se duart që luten!”, ka thënë Nënë Tereza. Dhe ne, nxënësit e Fultzit i zgjatëm duart sado pak, për të ndihmuar. Nuk bëmë gjë tjetër veçse shërbyem në mensën e Kryqit të Kuq. Këtu ofrohet dreka falas për të moshuar në nevojë. Por nuk ka fjalë që përshkruan emocionin dhe mbresat e asaj dite.

Aty kishte të moshuar të cilët jeta i kishte përballur me sfida të forta. Kjo u dallohej në çdo rrudhë të fytyrës, në plagët e duarve, por përkundrazi dhimbjes që mbanin brenda shpirtit, ata shfaqnin vetëm mirënjohje. U lexohej në sy. Sa herë që i shihje të falnin një buzëqeshje që dukej sikur kishin kohë pa e dhënë.

Një zonjë me tha: “Paç sa më shumë suksese në jetë! Uroj të të kthehet njëqindfish dashuria që ti fal!”.

Unë atje nuk shkoja të merrja diçka në këmbim, por kur dola nga ajo ndërtesë isha e mbushur me dashuri. Mësova të jem më empatike, mendoj se mësova dhe se çështë dhembshuria dhe mbi të gjitha mësova se duhet të jem mirënjohëse për gjënë më të vogël në jetë, qoftë kjo dhe një buzëqeshje.

Klea Zalli, Ardea Hetoja



“LUFTO PËR JETËN”

Për vite me radhë muaji tetor është konsideruar si periudha kur të tërë duhet të ndërjegjësohemi për sëmundjen e kancerit të gjirit. Kjo sëmundje, e cila prek me qindra gra, duhet të jetë gjithmonë në një kontroll të vazhdueshëm. Për këtë arsye, qendra të ndryshme spitalore ofrojnë mamografi apo “check-up”-e në mënyrë që të inkurajojnë çdo grua në moshën 40 e sipër ta paraprijë sëmundjen dhe nëpërmjet diagnostifikimit të ketë mundësi t’i bëjë ballë në fazat e hershme. Gjithashtu nuk mungojnë aktivitete ndërjegjësuëse të OBSH si dhe ndihma nga kjo organizatë për të mbështetur diagnostifikimin e të gjitha grave të vendeve të treta.

Një veprimtari të tillë ndërjegjësuëse organizoi dhe shkolla jonë ditën e mërkurë në mjediset e bibliotekës me pjesëmarrjen e nxënësve Sidrita Serica, Arba Jasini, Klara Agolli, Ines Derhemi, Briana Marku, Marla Deva etj te klasave 1-1, 1-2 dhe 1-10.

Ato treguan punimet e tyre të tipit poster dhe pikturë, prezantimin e një power point-i dhe krijimit të fletëpalosjeve me informacione të sakta e të vlefshme. Ngjyra e këtij muaji sensibilizues është ngjyra rozë që ishte dhe kryefjala e kësaj veprimtarie, që nga koshi i mbushur me fongo në nuanca të ndryshme të rozës që iu shpërndanë të ftuarave e deri te tullumbacet në formën e fjongos rozë.



Në këtë veprimtari nuk mungoi as prania e profesionisteve të fushës të cilat përgëzuan nismën e shkollës për të kontribuar në sensibilizimin e masës së gjerë, por edhe ndanë përvojat e tyre personale me pacientët. Ato në mbyllje të veprimtarisë, u shprehën se, organizime të tilla ende mungojnë në shumë zona më pak të zhvilluara, përfshirë këtu Shqipërinë dhe botën, por përhapja e fjalës si sot, jo vetëm në tetor, por kurdo, mund të shpëtojë jetë.

Patjetër, që sensibilizimi më i fuqishëm vjen prej përvojave të kaluara dhe nuk mund të mungonin disa histori prekëse të grave, që luftuan me kurajo këtë sëmundje. Por, si çdo luftë, edhe kjo merr jetë të pafajshme.

Kjo s’do të thotë në asnjë moment, se shpresa duhet humbur, përkundrazi, në një jetë ku asgjë nuk është e sigurt, shansin më të mirë e ke, nëse me forcë dhe pozitivitet ia arrin përsëri të jetosh. Dhe kur në këtë luftë nuk je e vetme, ke një arsye më tepër se pse duhet të luftosh.

Prandaj, si shkolla “Harry Fultz” edhe gazeta “Laboremus” ia kushton këtë veprimtari të gjitha grave e vajzave, që kuptuan forcën që i karakterizonte në momentet kur mendonin se forca ishte gjëja e fundit që kishin.

Danja Sharrxhi, Alesia Kuçi.



Vizitë në kompaninë “Coca-Cola”

Udhëtimi nisi herët në mëngjes, pikërisht në orën 10:00, nga shkolla jonë. Nxënësit ishin të emocionuar dhe plot energji për këtë përvojë të jashtëzakonshme. Udhëtimi u krye me një autobus të mundësuar nga vetë Coca-Cola, një detaj i veçantë që i bëri nxënësit të ndiheshin ende më afër kompanisë dhe veprimtarive të saj. Punonjësit e fabrikës së Coca-Cola i mikpritën nxënësit me ngrohtësi dhe i udhëzuan rreth rregullave të sigurisë që duhet të ndiqnin gjatë vizitës se tyre në këtë mjedis të veçantë. Ata këmbëngulën se nxënësit duhet të kishin kujdes të madh kur ecnin brenda fabrikës për t'u siguruar që do të respektonin rregullat dhe do të kishin një vizitë të sigurtë. Pas kësaj, kur u futën brenda dhe u ulën në vendet e tyre, punonjësit e Coca-Cola u ofruan nxënësve një prezantim tërheqës rreth historisë së kompanisë. Ata mësuan se kompania u hap në vitin 1994 dhe fabrika në Shqipëri u ngrit me një investim fillestar prej 12 milionë dollarësh. I rëndësishëm është fakti që koha e duhur për ndërtimin e fabrikës ishte vetëm 84 ditë, një rezultat i madh që tregon aftësinë dhe përkushtimin e kompanisë.



Por ajo që na përshtypjen më të madhe të nxënësit ishte ndikimi pozitiv i kompanisë Coca-Cola në mjedis. Ata janë një prej firmave të rralla që kanë arritur të përdorin ambalazhimin 100% të riciklueshëm, duke treguar se mund të jenë lider në kujdesin ndaj planetit tonë. Makinat e tyre të transportit janë tashmë elektrike, duke u bërë një shembull për kompanitë e tjera të mëdha. Përveç kujdesit ndaj mjedisit, Coca-Cola ka ndërmarrë projekte ekologjike të shumta. Ata kanë mbjellë rreth 1000 pemë, duke ndihmuar në ruajtjen e natyrës dhe të mjedisit. Në fakt, ata kanë krijuar një skuadër vullnetare për pastrimin e plazheve, duke kontribuar në pastrimin dhe ruajtjen e bregdetit dhe oqeanit.

Në fakt, ata kanë krijuar një skuadër vullnetare për pastrimin e plazheve, duke kontribuar në pastrimin dhe ruajtjen e bregdetit dhe oqeanit. Një tjetër arritje e madhe është se kompania ka prodhuar 4,700,000 paketime të ricikluara të produkteve gjatë vitit 2021, duke ndihmuar në zvogëlimin e ndotjes së mjedisit. Në fabrikën e Coca-Cola punojnë 342 persona dhe bashkëpunojnë me rreth 400 furnitorë lokalë, duke përmirësuar ekonominë vendase. Pas prezantimit të pasur dhe frymëzues, punonjësit e fabrikës u ofruan vizitorëve një drekë të shijshme dhe mundësinë për të luajtur disa lojra argëtuese. Kjo ishte një mënyrë e mrekullueshme për nxënësit tanë për të ndërtuar lidhje, për të shijuar kohën dhe për të mësuar më shumë për ekipin dhe kulturën e kompanisë Coca-Cola. Vizita në fabrikën e Coca-Cola ishte një përvojë e mrekullueshme që do të ndikonte në zhvillimin dhe ndërgjegjësimin e nxënësve. Ata u frymëzuan për të ndërmarrë veprime pozitive në mjedis, ekonomi dhe shoqëri. Frymëzim ky, që do t'i shoqërojë në rrugën e tyre të ardhshme.

Mateo Tollumi



Nxënësit e “Harry Fultz-it” “eksplorojnë botën e auditimit dhe konsulencës financiare në “Kreston Albania”!

Nxënësit e vitit të katërt të degës së biznesit në Institutin “Harry T. Fultz” kanë kaluar një ditë pranë kompanisë “Kreston Albania.” Kjo ngjarje u lejoi atyre të njiheshin me më shumë se sa librat shkollorë mund t’ju ofronin. Ata patën mundësinë të eksploronin botën e auditimit, sigurisë financiare, konsulencës ekonomike, ligjore, fiskale dhe kontabilitetit.

Fillimisht, nxënësit u prezantuan me profesionin e auditimit dhe mësimet e rëndësishme që ofrohen nga “Kreston Albania.” Përmes dhe prezantimeve, nxënësit arritën të kuptonin thellësisht rëndësinë e auditimit dhe ndikimin që ka në çdo aspekt të një biznesi.

Në vazhdim të vizitës, nxënësit janë nxitur të hulumtojnë rolin që “Kreston Albania” ka në sigurinë financiare të klientëve të saj. Ata janë njohur me mënyrat se si kompania analizon me kujdes të dhënat financiare dhe ofron rekomandime për përmirësim. Ky diskutim i ofroi nxënësve një perspektivë të hollësishme mbi sfidat dhe potencialet e kësaj fushe të ndërlikuar.

Por vizita nuk u mbyll vetëm me të dhëna teknike. Nxënësit u fokusuan gjithashtu në ndikimin e konsulencës ekonomike, financiare, ligjore dhe fiskale në menaxhimin e një biznesi. Ata morën pjesë aktivisht në diskutimet mbi mënyrat se si “Kreston Albania” personalizon shërbimet e saj për të ndihmuar klientët të përballojnë sfidat komplekse të fushës. Në përfundim të vizitës, nxënësit bënë një analizë të detajuar të mënyrës se si kompania menaxhon llogaritë financiare të klientëve, duke përfshirë proceset e organizimit të llogarive në modulën “Krijimi i ndërmarrjes, organizimi i llogarive.”

Ata u udhëzuan nga ekspertët e kompanisë mbi praktikën më të mira dhe metodat e përdorura për të siguruar që llogaritë janë të sakta dhe të besueshme.

Është një hap shumë i mirë që po organizohen veprimtari të këtij lloji për nxënësit e klasave të 12-13-a. Ky lloj bashkëpunimi midis shkollës dhe kompanisë mund të jetë një mënyrë shumë efektive për të ofruar një përvojë praktike dhe për të nxitur interesin e nxënësve për fushën që kanë zgjedhur.

Në intervistën që morëm prej nxënësve pjesëmarrës në vizitën që bëmë në “Kreston Albania”, sollëm këto mbresa:

1: Si do ta përshkruani vizitën tuaj te Kreston Albania?

- Ishte një vizitë shumë e vlefshme. Ne njohëm strukturën dhe shërbimet e kompanisë, si dhe mësuan më shumë rreth ekonomisë së Shqipërisë.

2: Cili ishte qëllimi i vizitës suaj?

- Njohja me kompaninë, ndihma për krijimin e kompanive dhe udhëzime për dokumentacionin financiar. Diskutuan proceset e themelimit dhe taksat që ndikojnë në bizneset dhe individët.

3: A keni komunikuar me punonjës të kompanisë dhe cila ishte përvoja e tyre?

- Po, komunikua me një ish-nxënëse e Fultzit, e punësuar prej vitesh te Kreston. Ishte e përgatitur dhe na ndihmoi me informacione konkrete dhe të vlefshme.

4: Çfarë ju bëri më shumë përshtypje gjatë vizitës suaj?

- Na bëri përshtypje atmosfera e ngrohtë dhe mikpritja e punonjësve të kompanisë. Ishte një bisedë e produktive dhe e këndshme, që do të mbahet mend.

5: Si mendoni që mund të përdoren njohuritë që morët nga vizita në jetën tuaj të përditshme?

- Njohuritë që fituam do të na ndihmojnë të kuptojmë më mirë ekonominë dhe tregun, dhe të jemi më të përgatitur për sfidat e biznesit dhe ekonomisë së sotme.

Sindi Çafaj



HKËMBIM PËRVOJE NË “KRESTON ALBANIA”

MËSIMI DHE SPORTI

Nelson Mandela ka thënë: “Aktiviteti fizik nuk është vetëm çelësi i një shëndeti të mirë fizik, por edhe i një mendjeje të paqtë.”

Ky citat shpreh më së miri rëndësinë e madhe që mbart veprimtaria fizike, sepse nuk të ofron vetëm një trup të shëndetshëm, por edhe një mirëqenie të përgjithshme të shëndetit mendor dhe emocional. Të mirat që sjellin sportet dhe edukimi fizik janë të pafundme, por kur integrohen edhe me procesin mësimor janë akoma dhe më efektive.

Shkolla “Harry Fultz” njihet si një institucion që e ka veprimtarinë fizike një pikë shumë të fortë dhe një aspekt thelbësor në tërësinë e saj. Ndër vite ne kemi treguar aftësitë tona në sporte të ndryshme, pjesëmarrjen në ndeshje miqësore si brenda shkollës ashtu edhe jashtë saj dhe kemi dalë fitimtarë në shumë raste. Organizimi më kryesor sportiv i shkollës tonë është “Dita Olimpike”, një traditë shumëvjeçare, e cila fillon me ndezjen e flakadanëve plot emocion dhe përmbyllet me performancën e mrekullueshme të vajzave të grupit të aerobisë. Kjo traditë është kaq e veçantë, sepse bashkon tërë nxënësit me dashurinë që kanë për sportin.




Veprimtaria fizike në “Fultz” nuk paraqitet vetëm gjatë orës së edukimit fizik, por dhe në hapësira të lira midis orëve mësimore, si për shembull shumë herë gjatë pushimit të madh kryhen ndeshje basketbolli, volejboli ose grupi i aerobisë performon një kërcim të kombinuar me lëvizje akrobatike nën tingujt e një muzike ritmike. E mira e kësaj ideje është se përveç vënies në lëvizje të trupit, krijon edhe ndjenjë harmonie përreth mjediseve të shkollës por edhe një frymë bashkëpunuese midis nxënësve. Gjithashtu, kjo është edhe një mënyrë perfekte për të çliruar stresin që mund të shkaktojë mësimet dhe për të rritur nivelin e përqendrimit dhe të angazhimit gjatë procesit mësimor.

Arsyeja se pse shkolla jonë i mëshon ndërlihdjes së mësimin me sportin është sepse ata plotësojnë njëri-tjetrin. Kjo lidhje i mëson studentëve punën në grup dhe disiplinën, por më e rëndësishmja është se ndihmon në të qenit më të sjellshëm në jetën e përditshme. I tërë ky realizim nuk do të arrihej pa punën e palodhshme të stafit të departamentit të edukimit fizik që çdo ditë përpunon që ne të përvetësojmë disiplinën e sportit në mënyrën më të mirë të mundshme. Përkushtimi që ata tregojnë është një ndër elementët kryesor që na shtyn për të dhënë përpjekjen tonë më të mirë, sepse kjo do të na dhurojë cilësi që do të jenë thelbësore në ndjekjen e qëllimeve afatgjata.

Këto janë disa prej komponentëve që e bëjnë të veçantë shkollën “Harry Fultz” dhe ia rrisin vlerat, sepse të ndërtohet një kombinim aq të mirë midis të mësuarit dhe sportit është një meritë e madhe, që gjithashtu ndikon në humorin tonë duke patur një përvojë shkollërore sa më pozitive, me ditë plot gjallëri dhe atmosferë të këndshme.

Alesia Kuçi



DITA EUROPIANE E GJUHËVE TË HUAJA

Në kuadër të Ditës Europiane të Gjuhëve të Huaja, më datën 26 Shtator në shkollën tonë u zhvillua një veprimtari e organizuar nga mësuesët dhe profesorët e departamentit të gjuhëve të huaja. Së bashku me nxënësit e vitit të parë e të dytë arritën të realizojnë këtë projekt të këndshëm. Klasat që morën pjesë në këtë veprimtari duhej të bënin një prezantim sipas shortit të hedhur më parë. Veprimtaria u bë e mundur në mjediset e bibliotekës së shkollës. Nxënësit pjesëmarrës kishin përgatitur prezantime në powerpoint me informacione mbi kulturën, të kaluarën artistike dhe historike, traditat dhe kulinarinë e shtetit të zgjedhur. Nga teoria në praktikë. Veç projekteve të punuara në grup, disa klasa prezantuan gatime spanjolle, turke, italiane dhe franceze të shërbyera për të ftuarit në publik. Fillimisht, secila klasë zgjodhi tre nxënës për të prezantuar projektin. Ndërsa ditën e shfaqjes, nuk pati rëndësi kush u ngjiti dhe prezantoi apo sa njerëz e paraqitën. E vetmja gjë që kishte rëndësi, ishte që puna të ishte bërë siç duhet dhe të ishte realizuar me sukses.



Veç këtyre prezantimeve, profesori i gjuhës gjermane së bashku me nxënësit e tij, kishin përgatitur një skenë aktrimi në gjuhën gjermane. Pjesa u interpretua shumë mirë. Aktorët i dhanë jetë personazheve të tyre dhe i bënë të gjithë të ndiheshin sikur ishin pjesë e dialogut. Ky inskenim i bukur gjerman ishte një pushim i këndshëm dhe i butë nga të gjithë prezantuesit anglishtfolës, u duk si qershia mbi tortë.

Të gjithë nxënësit që ishin pjesë e projektit u ndjenë të vlerësuar nga publiku dhe krenarë për punën që kishin bërë. Për shumë prej tyre, kjo ishte veprimtaria e tyre e parë në “Harry Fultz”.

Punuan në grup dhe i morën punët e tyre shumë seriozisht. Kjo veprimtari përcolli një mesazh bashkimi ndër të gjithë ne. Nëse flasim me gjuhën e bashkëpunimit, ndihesh një qytetar i familjes së madhe europiane!

Klara Agolli

TAPAT PLASTIKE

Të gjithë e dimë sa e dëmshme është plastika për shëndetin tonë, por një mënyrë e dobishme e përdorimit të saj është riciklimi. Shumë vende e ndërrmarje përpunon të ndihmojnë planetin. Shkolla jonë iu bashkua kësaj nisme. “Harry Fultz” bashkë me nxënësit e saj u organizua për dhurimin e tapave plastike, pasi sipas motos “Një gjest, një ndihmë”, edhe gjëja më e vogël kishte shumë vlerë. Kështu, të gjithë nxënësit e shkollës për grumbullimin e tapave, arritën të sillnin mesatarisht rreth njëzet tapa për person. Me ndihmën e përfaqësuesve të tjerë, në datën 26 nëntor, do të kryhet dorëzimi i këtyre tapave plastike. Vlerat mbledhur prej tyre, do të shkojnë në ndihmë të njerëzve të paralizuar, duke u mundësuar karrige lëvizëse për t’u lehtësuar jetën e tyre të përditshme. Instituti arsimor “Harry Fultz” me këtë bashkëpunim na tregon se gjithkush mundet të dhurojë dashuri edhe nëpërmjet gjërave më të vogla, mjafton edhe një tapë shisheje për të sjellë buzëqeshjen e njerëzve në nevojë.

Me shpresën për më të mirën, urojmë të sjellim frymëzimim e një gjesti te çdo njeri për të pasur e krijuar një botë sa të këndshme dhe të bukur për të gjithë.

Armando Shkëmbi

